



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.1

Prishtinë, më 26.12.2014 ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N – 303

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaku, Alma Lama, Shqipe Pantina, Pal Lekaj dhe Jelena Bontic.

Mungoi: Zafir Berisha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësues të OSBE-së, KDI-së, përfaqësuesi i medieve të Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Mbledhja konstituive e Komisionit;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Mbledhja konstituive e Komisionit;

Zenun Pajaziti – hapi mbledhjen konstituive, uroi deputetët e rinj, të cilët kanë mandatin e parë në Kuvend, ai shprehi gatishmërinë se do të bashkëpunojë me të gjithë anëtarët e komisionit pa dallim politik duke i respektuar rregullat dhe procedurat konform rregullores së punës.

Ai njoftoi anëtarët e komisionit se ka kërkuar nga administrata që anëtarëve të komisionit t'ju ofrohet lista e ligjeve të cilat bien në fushëveprimtarinë e komisionit, gjithashtu i njoftoi anëtarët se komisioni ka pasur një angazhim për fusha të ndryshme, si mediat, pushteti lokal dhe reformimi i administratës publike dhe si anëtarë të komisionit do të angazhohemi të punojmë sipas agjendës dhe obligimeve që na përcakton kushtetuta dhe ligji.

Alma Lama – propozoi, që përveç agjendës që komisioni do ta cakton, planit të punës, anëtarët e komisionit të ndahen në grupe punuese brenda komisionit për monitorimin e ligjeve për të cilat komisioni i përcakton si më të rëndësishme.

Shqipe Pantina – propozoi pjesëmarrjen në grupin punues për reformën administrative.

Sadri Ferati – duke u deklaruar për një përvojë të mirë të komisionit nga legjislatura e kaluar, kërkoi që komisioni të ketë qasjen e njëjtë në kontest të harmonizimit të qëndrimeve brenda anëtarëve të komisionit.

Pal Lekaj – tha se do të jetë konstruktiv dhe do të mbështes çdo ide që shkon në favorizim të reformave sidomos në administratë dhe qeverisjen lokale.

Kujtim Paçaku – tha se do të jap kontributin e vet në media dhe qeverisje lokale si sfidat më të mëdha duke i plasuar çështjet e mbetura nga legjislatura e kaluar.

Jelena Bontic – tha se do të dalim unik gjithnjë para Kuvendit.

Xhevahire Izma – diskutoi lidhur me digjitalizimin, propozoi që komisioni të ketë një listë për proceset lidhur me digjitalizimin dhe raportet ndërmjet institucioneve të cilat kanë të bëjnë me çështjen e ligjit.

3. Të ndryshme

Komisioni u takua me anëtarët e KPM-së të cilët e njoftuan komisionin se KPM-ja ka miratuar për konsultim publik tekstin e ndryshuar dhe plotësuar të draft strategjisë për kalimin në transmetimin digjital si dhe për afatet për dorëzimin e komenteve për draft strategjinë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
